



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 123/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 92734-11-05-2018, Loti II, me objekt: “*Blerje bulmet, qumësht, djathë, gjizë*”, me fond limit 59.495.617 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k.
Gorre, Lushnje
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë
Rr. “Barrikadave”, Tiranë
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “AGS” sh.p.k.
Rruga “Beqir Luga”, Pallati Nr.3, Shk.1/1 8. Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.11.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-92734-11-05-2018, Loti II, me objekt: “*Blerje bulmet, qumësht, djathë, gjizë*”, me fond limit 59.495.617 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 04.12.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | |
|----|----------------------|-------------------------------|
| 1. | “Delta Doni” sh.p.k. | 53.477.500 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Nelsa” sh.p.k. | 55.234.000 lekë, skualifikuar |
| 3. | “AGS” sh.p.k. | 58.897.800 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 18.12.2018 operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Kriteret e përgjithshme pika 1.d, pas verifikimit në sistemin e-albania nga KVO (referuar Kriteret të Përgjithshme: në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga OE) rezultojnë se operatori ekonomik ka detyrime tatimore të papaguara, sipas vërtetimit Nr.T00734265, datë 17.12.2018.

II.4. Në datën 24.12.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon se:

[...] Oferta e shoqërisë sonë është skualifikuar sepse nga verifikimi i kryer nga KVO në sistemin e-albania rezultojnë me detyrime tatimore të papaguara.

Sa më sipër duke analizuar arsyen e ngritur ju sqarojmë:

Më datë 14.12.2018 datën e hapjes së ofertave kemi paraqitur në sistem vërtetimin nr. 2482 prot., datë 26.11.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier se shoqëria jonë nuk ka detyrime të papaguara.

Në vijim të pretendimit tuaj për të zbardhur të vërtetën, jemi drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me shkresën nr. 21367 prot., datë 20.12.2018.

Po më datë 20.12.2018 me shkresën nr. 21367/1 prot., Drejtoria Rajonale Tatimore Fier na kthen përgjigje duke detajuar gjithçka dhe duke hedhur poshtë pretendimin e KVO për detyrime të papaguara.

Shoqëria jonë nuk ka pasur dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara përveç detyrimeve koherente për muajin fiskal Dhjetor 2018 (sipas detajimit të legjislacionit tatimore 2014, Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998) brenda afatit ligjor për tu paguar.

Në respekt të këtyre afateve tatimore kemi paguar brenda datës 20.12.2018 detyrimet koherente të muajit përkatës, ashtu sikurse çdo muaj paraardhës.

Shoqëria jonë ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim sipas DST si dhe ka ofruar ofertën më të leverdisshme për AK me një efekt prej 5.420.300 lekë nga operator i vetëm dhe i fundit i kualifikuar.

Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria jonë.

II.5. Me shkresën nr. 1636/5 prot., datë 26.12.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...] - në ligjin 9643[..] neni 45 dhe 46 theksohet qartë se, operatorët ekonomikë duhet të kualifikohen vetëm pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret.

- referuar DST, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në ditën e hapjes së ofertave. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

- KVO kreu verifikimin në sistemin zyrtar e-albania më datë 17.12.2018 për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë nga ku rezultoi se vetëm "Delta Doni" sh.p.k. kishte detyrime të papaguara tatimore (sipas formularit bashkëlidhur).

- ky fakt përbën kusht skualifikues sa më sipër.

- Vërtetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, bashkangjitur ankesës nr. 21367/1 prot., ka si datë 20.12.2018. Në paragrafin e fundit të kësaj shkrese citohet qartë: “Në sistemin cats detyrimet koherente janë për sigurimet shoqërore Nëntor 2018 me vlerën 276436 lekë, kështu Tatim fitimi Dhjetor 2018 është në vlerën 82059 lekë dhe tatim i mbajtur në burim Nëntor 2018 në vlerën 3750 lekë, pra total detyrim në vlerën 362245 lekë”.

Gjithashtu ankesa juaj është shoqëruar me shkresa, urdhër pagesa, si dhe njoftim debitimi i Bankës Raiffeisen, të cilat mbajnë datat 19.12.2018 dhe 20.12.2018. Klasifikimi në sistem nga KVO është bërë më datë 18.12.2018, ndërsa publikimi më datë 19.12.2018.

Ju si operator ekonomik keni marrë dijeni më datë 19.12.2018 ndërsa veprimet për likuidimet e detyrimeve i keni kryer më datë 20.12.2018.

- Siç vërehet qartë dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore nuk rezulton të jetë paraqitur në sistem ditën e hapjes së ofertave si dhe vërteton se ky kriteri nuk ka qenë i përmbushur nga ofertuesi deri më datë 18.12.2018 që është bërë vlerësimi nga KVO.

Pavarësisht afatit kohor të përmuajshëm për likuidimin e detyrimeve tatimore, çdo operator ekonomik i cili është pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore në momentin e ofertimit referuar ligjit sa më sipër[...].

II.6. Në datën 04.01.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

[...] Në kthimin e përgjigjes autoriteti kontraktor e anashkalon me qëllim detajimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për detyrimet e prapambetura (të paguara më datë 25.01.2018 në vlerë 60.000 lekë por të pasistemuara në sistemin C@t's).

Deri më datë 04.12.2018 (datën e hapjes së ofertave) sikurse konfirmon dhe vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier shoqëria jonë nuk ka pasur asnjë detyrim të papaguar ndërsa detyrimet koherente të muajit dhjetor 2018 janë paguar sipas detajimit të legjislacionit tatimor, ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 brenda afatit ligjor për tu paguar (datë 20.12.2018).

Edhe pse detyrimi prej 60.000 lekë është paguar më datë 25.01.2018 akoma vazhdon të pasqyrohet si detyrim i papaguar pasi është i pasistemuar në sistemin tatimor sepse çështja është në apelim gjyqësor.

Shoqëria jonë ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim sipas DST si dhe ka ofruar ofertën më të leverdisshme për AK me një efekt prej 5.420.300 lekë. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria jonë.

II.7. Në datën 10.01.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1636/8 prot., datë 10.01.2019, me objekt: “Dërgim informacioni mbi ankesën e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” “Marrëveshje kuadër me afat 12 mujor me objekt “Blerje ushqime ndarë në 5 lote”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k.

II.7. Në datën 05.02.2019, me shkresën nr. 176 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për informacion dhe sqarim në lidhje me detyrimet që rezultojnë në emër të shoqërisë “Delta Doni” sh.p.k. në mënyrë analitike.

II.8. Në datën 05.03.2018 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa nr. 8551/1 prot., datë 01.03.2019 e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila i drejton për kompetencë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, shkresën e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.9. Në datën 05.03.2019, nëpërmjet e-mailit zyrtar të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, është dërguar shkresa me nr. 3346/1 prot., datë 05.03.2019 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në lidhje me kërkesën e bërë nga KPP më datë 05.02.2019.

Në këtë shkresë Drejtorja Rajonale Tatimore Fier sqaron se:

[...]

Subjekti në datën 04.12.2018 ka rezultuar me situatë debitore dhe kreditore për periudhën Tetor 2017 në shumën 60.000 lekë.

Në periudhën Tetor 2017 ka patur si detyrime gjobë në vlerën 50.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018 dhe gjobë në shumën 10.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018.

Duke qenë se subjekti ka apeluar detyrimin rezulton se në sistemin tonë debitore dhe kreditore në të njëjtën vlerë pasi çështje e hapur për apelim nuk mundëson kryerjen e kontabilizimit të pagesës për detyrimin e periudhës përkatëse pra për rrjedhojë nuk është kryer sistemimi i pagesave në vlerën 60.000 lekë në sistemin C@ts.

Në sistemin C@ts në datën 04.12.2018 ka patur detyrimet koherente Këst tatim fitimi Dhjetor 2018 në vlerën 82059 lekë, afati i pagesës datë 30.12.2018, subjekti ka kryer pagesën në datën 20.12.2018.

Përsa më sipër konfirmojmë se subjekti nuk ka detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore në datën 04.12.2018”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, është përcaktuar shprehimisht se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Shtojca “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, ku deklarohej se “Operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi”.

III.1.3. Në nenin 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç);

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së, sqaron se: “- në ligjin 9643[..] neni 45 dhe 46 theksohet qartë se, operatorët ekonomikë duhet të kualifikohen vetëm pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret.

- referuar DST, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në ditën e hapjes së ofertave.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

- KVO kreu verifikimin në sistemin zyrtar e-albania më datë 17.12.2018 për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë nga ku rezultoi se vetëm “Delta Doni” sh.p.k. kishte detyrime të papaguara tatimore (sipas formularit bashkëlidhur).

- ky fakt përbën kusht skualifikues sa më sipër.

- Vërtetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, bashkangjitur ankesës nr. 21367/1 prot., ka si datë 20.12.2018. Në paragrafin e fundit të kësaj shkrese citohet qartë: “Në sistemin cats detyrimet koherente janë për sigurimet shoqërore Nëntor 2018 me vlerën 276436 lekë, këst Tatim fitimi Dhjetor 2018 është në vlerën 82059 lekë dhe tatim i mbajtur në burim Nëntor 2018 në vlerën 3750 lekë, pra total detyrim në vlerën 362245 lekë”.

Gjithashtu ankesa juaj është shoqëruar me shkresa, urdhër pagesa, si dhe njoftim debitimi i Bankës Raiffeisen, të cilat mbajnë datat 19.12.2018 dhe 20.12.2018. Klasifikimi në sistem nga KVO është bërë më datë 18.12.2018, ndërsa publikimi më datë 19.12.2018.

Ju si operator ekonomik keni marrë dijeni më datë 19.12.2018 ndërsa veprimet për likuidimet e detyrimeve i keni kryer më datë 20.12.2018.

- Siç vërehet qartë dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore nuk rezulton të jetë paraqitur në sistem ditën e hapjes së ofertave si dhe vërteton se ky kriteri nuk ka qenë i përmbushur nga ofertuesi deri më datë 18.12.2018 që është bërë vlerësimi nga KVO.

Pavarësisht afatit kohor të përmuajshëm për likuidimin e detyrimeve tatimore, çdo operator ekonomik i cili është pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore në momentin e ofertimit referuar ligjit sa më sipër. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë provë për vërtetimin e pretendimeve të tij”.

III.1.7. Nga ana tjetër, vetë operatori ekonomik i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për sqarimin e situatës me detyrimet që ka ky operator, në përgjigjen e së cilës konstatohet se: “[...]Në periudhën Tetor 2017 ju keni patur si detyrime Gjorbë në vlerën 50.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018 dhe gjorbë në shumën 10.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018.

Duke qenë se ju keni apeluar detyrimin ju shfaqeni në sistemin tonë debitore dhe kreditore në të njëjtën vlerë pasi çështje e hapur për apelim rezulton e papëfunduar dhe për rrjedhojë nuk është kryer sistemimi i pagesave në vlerën 60.000 lekë në sistemin C@ts. Përsa më sipër, ju nuk keni detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore për periudhën Tetor 2017.

Në sistemin C@ts detyrimet koherente janë për Sigurimet shoqërore Nëntor 2018 në vlerën 276436 lekë, Këst tatim fitimi Dhjetor 2018 është në vlerën 82059 lekë dhe Tatim i mbajtur në burim Nëntor 2018 në vlerën 3750 lekë, pra Total Detyrim në vlerën 362245 lekë.

III.1.9. Pas kërkesës për informacion të drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, Drejtorisë Rajonale Tatimore si organi kompetent dhe përgjegjës për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me detyrimet tatimore të shoqërive të ndryshme, kjo e fundit, në përgjigjen e sjellë, sqaron se: “Subjekti në datën 04.12.2018 ka rezultuar me situatë debitore dhe kreditore për periudhën Tetor 2017 në shumën 60.000 lekë.

Në periudhën Tetor 2017 ka patur si detyrime gjorbë në vlerën 50.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018 dhe gjorbë në shumën 10.000 lekë e cila është paguar në datën 25.01.2018.

Duke qenë se subjekti ka apeluar detyrimin rezulton se në sistemin tonë debitore dhe kreditore në të njëjtën vlerë pasi çështje e hapur për apelim nuk mundëson kryerjen e kontabilizimit të pagesës për detyrimin e periudhës përkatëse pra për rrjedhojë nuk është kryer sistemimi i pagesave në vlerën 60.000 lekë në sistemin C@ts.

Në sistemin C@ts në datën 04.12.2018 ka patur detyrimet koherente Këst tatim fitimi Dhjetor 2018 në vlerën 82059 lekë, afati i pagesës datë 30.12.2018, subjekti ka kryer pagesën në datën 20.12.2018.

Përsa më sipër konfirmojmë se subjekti nuk ka detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore në datën 04.12.2018”.

III.1.10. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë KPP – së, ka depozituar edhe dokumentat “Urdhër pagesë” të bëra për detyrimet koherente që rezultonin në sistem, detyrime këto që shënojnë se janë nxjerrë në datën 19.12.2018 dhe mbajnë vulën e datës 20.12.2018.

III.1.11. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.13. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, referuar edhe dokumentacionit të sjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, nuk rezulton me detyrime tatimore të prapambetura, por deri në datën 04.12.2018, ka vetëm detyrimet koherente Këst tatim fitimi Dhjetor 2018, të cilat kanë si afat pagese deri në datën 30.12.2018, e të cilat janë paguar në datën 20.12.2018, pra brenda afatit të përcaktuar ligjor. Sqarojmë autoritetin kontraktor se detyrimet koherente të cilat kanë një afat të përcaktuar ligjor, nuk është e detyrueshme të paguhen përpara datës së hapjes së ofertave për një procedurë të caktuar prokurimi, përse kohë që legjislacioni përkatës përcakton një afat me diapazon të gjerë edhe pas datës së hapjes së ofertave.

Akoma më tej, Drejtoria Rajonale Tatimore deklaroi se: “*konfirmojmë se subjekti nuk ka detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore në datën 04.12.2018*”.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm e, rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 92734-11-05-2018, Loti II, me objekt: “*Blerje bulmet, qumësht, djathë, gjizë*”, me fond limit 59.495.617 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 15 Protokolli

Datë 04.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha